



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 38/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe znj. Myjesere Mujku, anëtare të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private znj. _____, si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 11.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

KONSTATOHEN të tërhequra Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL. nr 38/2021, datë 05.10.2021 si dhe Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses private znj. _____ i datës 21.09.2021, i paraqitur nga z. _____ i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 21.09.2021, z. _____ i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës ka paraqitur Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses private znj. _____ si organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ pasi që e njëjta nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet për anëtarësi ndaj Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës për vitin 2020. Sipas propozimit, administrata e Odës disa herë ka dërguar kërkesa përmes adresës elektronike tek përmbaruesja private, ajo është kontaktuar edhe përmes telefonit si dhe janë shfrytëzuar kuvendet ose trajnimet për t'ia rikujtuar obligimin për të përmbushur detyrimet në pajtim me vendimin e Kuvendit të Odës së Përmbaruesve të Kosovës të dt 04.03.2021, por e njëjta ka paguar një pjesë të detyrimeve ndërsa pjesën tjetër të detyrimit edhe pse ka premtuar nuk e ka përmbushur.

Me datën 05.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj

përmbardueses private znj.
Themelore në

si organ përmbardues i emëruar për Territorin e Gjykatës

Me dt 07.10.2021, përmbarduesja private znj. [i është njoftuar nga Komisioni Disiplinor se Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Profesione të Lira, me dt: 05.10.2021, ka paraqitur pranë Komisionit Disiplinor, raport për fillimin e procedurës disiplinore, për dyshime të shkeljeve disiplinore nga ana e saj, në cilësinë e përmbardueses private. Komisioni Disiplinor, konform nenit 3.9 të Udhëzimit Administrativ MD-nr.09/2014, për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbarduesit Privat (të miratuar nga Ministria e Drejtësisë me dt.13.05.2014), ka njoftuar të njëjtën se ka të drejtën që të deklarohet me shkrim në adresën e Komisionit Disiplinor, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të njoftimit. Po ashtu, përmbarduesja private znj. [është njoftuar që konform këtij neni, parashtresa mund të përmbajë të dhënat dhe opinionin saj lidhur me përgjegjësinë disiplinore, si dhe faktet dhe argumentet për të mbështetur pozitën saj ligjore. Komisioni Disiplinor megjithatë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga ana e përmbardueses private.

Me datën 05.11.2021, Komisioni Disiplinor ka pranuar Kërkesën nr.08-1775 nga kryetari i Odës së Përmbarduesve Privat të Kosovës. Sipas kërkesës, pasi që përmbarduesja private znj. ka përmbushur detyrimet e saj lidhur me pagesat e kontributeve, parashtresi konform nenit 366 dhe 367 par 1.11, të Ligjit për Procedurën Përmbardimore tërhiqet nga propozimi për fillimin e procedurës disiplinore.

Me datën 11.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ndërsa përmbarduesja private, znj. dhe përfaqësuesi i Odës së Përmbarduesve Privat të Kosovës edhe pse ishin të njoftuar nuk kanë prezantuar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj. Fadilete Hoxha ka theksuar se pasi që paraqitësi i propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ka njoftuar Komisionin Disiplinor se përmbarduesja private znj. ka përmbushur detyrimet e saj dhe tërheqin propozimin, atëherë, edhe Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat tërhiqet nga Raporti përfundimtar DPL. Nr 38/21, dt 05.10.2021, i paraqitur në Komision Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARDUESIT PRIVAT
DPL.nr 38/2021, datë 11.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.